



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**

KUKES

Adresa: Sheshi "Skenderbej" Kukes

Nr. 96 Prot

Kukes, me 07.02.2023

Lënda : Strategjia dhe prioritetet afatgjatë në kuadrin e deklaratës së misionit e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukes,

Drejtuar :

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

TIRANË

DEKLARATA E MISIONIT

Është hartuar në kuadrin gjithë përfshirës të deklaratës së misionit për gjithë gjyqësorin por edhe në mënyrë të vecantë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukes, Përbushja e funksionit kushtetues të institucionit në dhënien e drejtësisë duke garantuar njëproces të rregullt ligjor ,transparencë dhe profesionalizëm, infrastrukturë të nevojshme logjistike dhe ambjent të përshtatshëm për kryerjen e këtij shërbimi,mbështetur në standartet e planifikimit , zbatimit dhe menaxhimit të buxhetit për shpenzimet operative dhe investime.

Misioni i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukes shkon përkrah misionit të KLGJ .-së i cili është: Menaxhimi me efektivitet dhe eficencë i fondeve buxhetore, të miratuara për pushtetin gjyqësor me ligjin e buxhetit, për të mbështetur pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjithashtu në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Gjykata ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve dhe akteve nënligjore, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritimit europian të Republikës së Shqipërisë.

STRATEGJIA DHE PRIORITETET AFATGJATË

Objektivat	Agregatet dhe instrumentet	Periudha	Institucione bashkëpunues
Konsolidim i statusit të gjyqtarëve	Rritje profesionale ,trajnime	Në vazhdimësi	Shkolla e Magjistratures, KLGJ,
Mbështetja për kulturën juridike	Trajnimet pranë Shkollës së Magjistraturës. Trajnime të tjera .Njohje e publikut me të drejtat sipas ligjit për të drejtën e informimit etj	Në vazhdimësi	Shkolla e Magjistratures, KLGJ,
Trajnimi i administratës gjyqësore me synim realizimin me cilësi dhe në kohe sa më të shpejtë të detyrave profesionale	Njohje me teknikat e reja të realizimit të punës, përmirësimi i sistemeve të punës	Në vazhdimësi	Shkolla e Magjistraturës, KLGJ
Garantimi i aksesit të publikut në gjykatë	Disponibiliteti i shërbimit	Në vazhdimësi gjatë orarit zyrtar të punës	Gjykata, KLGJ

Garantimi i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e seancave gjyqësore në kushtet e një performancë të lartë dhe transparencë për publikun	Funksionimi i sistemit ICMIS dhe sistemit të dixhitalizuar AUDIO në sallën e gjykimit në çdo seancë	Në vazhdimësi në çdo seancë	Gjykata, KLGJ
Përvetsimi i mendimeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare pozitive të partnerëve kombëtare dhe ndërkombëtare për përmirësimin e infrastrukturës së gjyqësorit	Pjesmarrja në konferenca , takime , simpoziume ,këshillime, konsulta etj në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së gjyqësorit	Në vazhdimësi	Shkolla e Magjistraturës, KLGJ,
Standartizimi i veprimtarisë ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor , udhëzimet e njësisë qendrore të varesisë ekonomike KLGJ , zbatimit të gjurmëve standarte të auditimit .	Dixhitalizimi i veprimtarisë ekonomike dhe pasqyrimi në programin alfaweb buxhetor në kuadrin enjësisëqendrore,zbatimi i rekomandimeve për gjurmët standarte të auditimit.Përditësimi sipas legjislacionit , Sipas rregullave standarte të Menaxhimit administrimit efektiv të fondeve buxhetor analizimi i efincës së shpenzimeve operative	Në vazhdimësi	Gjykata, KLGJ
Përsosja e sistemit BACK- UP të të dhënave dhe informacionit	Dixhitalizimi i veprimtarisë, dixhitalizimi dhe regjistrimi i seancave në sistemin audio I realizuar 100%	Në vazhdimësi	Gjykata, KLGJ
Garantimi i infrastrukturës persa i përket ambjenteve ku ushtrohet aktiviteti, shtimi i ambjenteve	Shtimi i ambjenteve sipas rekomandimeve të lëna detyrë nga grupi i auditimit	Në vazhdimësi	KLJG , ,
Dixhitalizimi i arkivës	Krijimi i arkivës dixhitale,në vazhdimësi	Në vazhdimësi	Gjykata, KLGJ

ZV/ KRYETARE E GJYKATËS

Merita Karaj

